



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 381, Datë 28.12.2023

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARJES SË BORDIT TË ERE-S PËR APLIKIMIN
E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2417/9 prot., datë 22.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e vendimarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2416 prot., datë 17.11.2023, ka paraqitur aplikimin për pajisje me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 354, datë 01.12.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 02.12.2023 dhe 04.12.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.12.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2417/5 prot., datë 07.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit nr. 354/2023 duke evidentuar dhe dokumentacionin/informacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417/6 prot., datë 11.12.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet e gjithashtu të sqarohet një pjesë e këtij

dokumentacioni me shoqërinë, ndaj me me shkresën nr. 2417/8 prot., datë 19.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për zhvillimin e një seance dëgjimore në ambjentet e ERE-s në datën 28.12.2023.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Për gjithë sa më sipër, në rrethanat kur është planifikuar seanca dëgjimore me shoqërinë e po ashtu duke marrë në konsideratë faktin se gjatë kësaj periudhe ka disa pushime zyrtare e po ashtu nevojitet koha për të shqyrtuar dokumentacionin që do të depozitohet në vijim nga shoqëria, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrja përfundimtare e bordit për aplikimet e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1,751 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI